



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 291/1 Prot.

Shkodër, më 4.04.2023

Lënda: Mbi Vendimin nr. 22, datë 29.03.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 18, neni 27, pika 5, neni 54, shkronja “e/1”, neni 55, pika 3, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, neni 25, pika 1, shkronja “b”, të VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve dhe te kullotave publike, sipas listave te inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, të ndryshuar, pika 49, shtojca 47, të VKM nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, shtojca 1/5, të Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr. 1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, të VKB Vau Dejës nr. 3, datë 25.01.2023 “Mbi miratimin e listës së ngastave/nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”, të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 2393 prot., datë 04.04.2023 “Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 29.03.2023”, shqyrtoi VKB nr. 22, datë 29.03.2023 “Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 0.66 ha, për agropylltari, ngastra nr. 11, ekonomia pyjore Drin Gjadër Kir”, sipas listës së miratuar VKB Vau Dejës nr. 3, datë 25.01.2023 “Mbi miratimin e listës së ngastave/nëngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”.

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedimin, sipas procedurave të konkurimit publik ne vazhdim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKT

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 22 datë 29.03.2023



**“Për dhënien në përdorim me afat 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 0.66 ha “Për Agropylltari
“në ekonominë pyjore Drin Gjadër Kirë.**

Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 29.03.2023, dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, mbështetur në nenin 9 pika 1.2 shkronja a , nenin 54 shkronja el, neni nr 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”, neni 25, **pika 49** e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, Udhëzimi i Ministrisë së Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat ,procedurat e kërimit,të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” **me shumicë votash:**

V E N D O S I

- 1.Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej **0.66** ha “Për Agropylltari”, në **ngastrën nr.11** të ekonominë pyjore **Drin Gjadër Kirë.**
- 2.Afati i dhënies me qera të jetë 10 (dhjete) vjet .
- 3.Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.
- 4.Efektet: Jep impakte pozitive tek komuniteti,sigurohen të ardhura të cilat kthehen në investime në fondin pyjor.
- 5.Ngarkohen Drejtorja e Pyjeve,Turizmit Dhe Mbrojtjes Së Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
- 6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika , të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

KRYETAR
Mark Bisha

Mark
Sekretari i Këshillit Bashkiak
Ardian Çelepija

Miratuar me 19 vota

Vota Pro 19

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 03.04.2023